



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
Date/datum: 31.10.18
PRISHTINË - PRISTINA

PSH.nr. 512 /18

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Nuhi Paçarizi– Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z., Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “El-Bau”shpk-Gjilan kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull prokurimit: “Mirëmbajtja dimërore e Rrugëve dhe trotuarëve, deblllokomi i kanalizimit atmosferik” me numër të prokurimit : 616-18-440-221, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) “KK-Prishtinë ”, më datën 23.10.2018 mori këtë:

V E N D I M

I. APPROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “El-Bau”shpk-Gjilan lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja dimërore e Rrugëve dhe trotuarëve, deblllokomi i kanalizimit atmosferik” me numër të prokurimit : 616-18-440-221, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues AK - KK-Prishtinë .

II. OBLIGOHET, autoriteti kontraktues /Komuna e Prishtinës / ti bëjë ndryshimet në dosje të tenderit, dhe të veproj konform nenit 53.7 të LPP-së, lidhur me aktivitetin të prokurimit “Mirëmbajtja dimërore e Rrugëve dhe trotuarëve, deblllokomi i kanalizimit atmosferik” me numër të prokurimit : 616-18-440-221.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “El-Bau”shpk-Gjilan aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 23.08.2018

Kundër njoftimit për kontratë lidhur me këtë aktivitetit të prokurimit, operatori ekonomik “El-Bau”shpk-Gjilan me dt: 22.09.2018, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Autoriteti Kontraktues me datën 24.09.2018 ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e OE: “El-Bau”shpk-Gjilan si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues “El-Bau”shpk-Gjilan si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 04.10.2018 me nr. 512 / 18, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Mirëmbajtja dimërore e Rrugëve dhe rrrotuarve, deblllokomi i Kanalizimit atmosferik” me numër të prokurimit : 616-18-440-221, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) “KK-Prishtinë”, duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1,7,66,69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Organi Shqyrtaues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 02.10.2018 ka autorizuar ekspertin shqyrtaues profesional të prokurimit për të shqyrtauar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtaues profesional në raportin e dt: 08.10.2018, lidhur me pretendimin ankimore te OE ankues “El-Bau”shpk-Gjilan në finalizim te analizimit dhe shqyrimit te këtij aktiviteti te prokurimit, konstaton si në vijim:

Në lidhje me pretendimin ankimore sa i përket kriterit të dosjes së te tenderit dhe njoftimit për kontratë pika 7.1&7.2, nën pika 3, lidhur me kriterin “Licenca për menaxhimin e mbeturinave”.

Eksperti shqyrtues vlerëson se nuk qëndron pretendimi ankimor për faktin se kjo Licencë nuk favorizon apo diskriminon asnjë OE sepse e njëjtë licencë mundet të ketë çdo OE i cili aplikon dhe plotëson kriterin për marrjen e licencës, Po ashtu ky dokument sipas sqarimit të Autoritetit kontraktues është i nevojshëm duke u bazuar në atë se asnjë kompani e pa licencuar nuk mundet të nënshkruar kontratë me deponim për menaxhimin e mbeturinave, që do të thotë se nuk mundet të dorëzoj mbeturinat e grumbulluar në qytet, pa marrur parasysh sezonin e mirëmbajtjes, grumbullimi dhe dorëzimi i mbeturinave është veprim i përditshëm dhe të njëjtat duhet të dorëzohen në deponi.

Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket kriterit të dosjes së te tenderit dhe njoftimit për kontratë pika 9.1&9.2, nën pika 3, lidhur me kriterin “

3. OE – duhet te ofroj dëshmi qe posedon apo ka ne shfrytëzim pajisjet e përshkruara ne Aneksin 7 te dosjes se tenderit

3. Listën e pajisjeve me dëshmitë: DUD-at për ato automjete qe nuk kane librezë te qarkullimit, Librezat e qarkullimit. Nëse mjetet janë në shfrytëzim kontratat për shfrytëzimin e tyre

Eksperti shqyrtues vlerëson se NUK qëndron pretendimi ankimor një herit kjo kërkesë është në harmoni me nenin 7 dhe 69.4.5 të LPP-së, për faktin se nuk diskriminon apo favorizon asnjë OE të interesuar për pjesëmarrje në këtë aktivitet të prokurimit, sepse dëshmja dokumentare e kërkuar për pajisjen të cilat nuk kanë librezë të qarkullimit ku është kërkuar të dëshmohet me DUD Doganor është në pajtim me dispozitat ligjore për faktin se DUD-i Doganor dëshmoi se pajisja është importuar dhe e njëjta është në pronësi të OE të caktuar. Një herit është e drejtë e AK-së të përcaktoj formën e kritereve në lidhje me dëshmitë dokumentare duke pasur parasysh nenin 7 të LPP-së, në rastin konkret kërkesat e vendosura të lartë cekura në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë për këtë aktivitet të prokurimit janë në harmoni me nenin 7 dhe 69 të LPP-së

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të REFUZOHET si e pabazuar (për arsyen që u cek më lart), dhe rekomandon Panelin shqyrtues që të lejoj AK-në të vazhdoj më tutje me këtë aktivitet të prokurimit në harmoni me dispozitat ligjore të LPP-së.

Operatori Ekonomik ankues përmes parashtresës me shkrim të datës: 11.10.2018 ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 09.10.2018, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet më raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 23.10.2018, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtuesi, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, operatori ekonomik ankues, ku shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues z. Pireva deklaroj: Nuk pajtohem me mendimin e ekspertit. Me 23.08.2018 është publikuar njoftimi për kontratë dhe ne si kompani kemi filluar për të përgatitur ofertën për konkurrim, ndërsa pas 17 ditëve me 10.09.2018 në E Prokurimi vjen një sqarim shtesë për OE ku thuhet “KK Prishtinë ka pranuar një pyetje nga OE lidhur me kërkesat përcaktuara në dosje të tenderit dhe pyetja është si në vijim “pse në dosje të tenderit nuk është kërkuar që kompanitë të kenë licencë për menaxhimin e mbeturinave” ”. Kjo për neve është diçka e veçantë, pasi nuk ka ndodh që OE-të të kërkojnë të vendosen kritere shtesë. AK të njëjtën ditë jep sqarim lidhur me licencën ku thotë “licenca për menaxhimin e mbeturinave kërkohet mirëpo njësia kërkesës në fillim nuk e ka paraqitur këtë kërkesë, por në sqarime sipas pyetjeve e kanë deklaruar se është e domosdoshme”. Pas kësaj kemi kërkuar sqarime dhe AK na është përgjigjur se kompania KMDK nuk lejon të deponohen mbeturinat në deponi pa pas licencë. Kjo nuk qëndron fare dhe për këtë kemi dy marrëveshje që lëmi lidhur për deponimin e mbeturinave me KMDK një e datë 19.04.2018 nga anëtari i konzrociumit dhe tjetra e datës 15.10.2018 nga ne si kompani, që i bie se ne edhe pse nuk jemi të pajisur me licencë mund të deponojmë mbeturina në depozitë e KMDK , si provë i ofroj panelit marrëveshjet tonë me KMDK, dhe pyetjen e OE. Për neve ka qenë diskriminim vendosja e kërkueses për licencë sepse ka qenë primare mirëmbajtja dimërore dhe vetëm një pozicion ka qenë zbrazja e shportave dhe deponimi tyre në deponi . Lidhur me nenin 9.1 dhe 9.2 pika 3 është kërkuar që lista pajisjeve dëshmitë, doganor për automjete që nuk kanë libreza dhe librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen, çka është kriter diskriminues, sepse edhe një freze dorës për pastrimin e borës të cilën mund ta blejmë që në qendër tregtare në Kosovë në bazë të kërkesës së AK duhet patjetër të ta doganojmë, çka nuk ka asnjë mundësi të vetme sepse këto gjenden në brendi të tregut të Kosovës, dhe si dëshmi ju ofroj faturën që e kemi blerë Freze Dore për pastrimin e borës. Si kërkesë e jona ka qenë që këto mjete dëshmohen me duda doganor, ose faturë, ose kontratë. PO ashtu ju ofroj dëshmi interpretimin e KRPP-së se kjo është kërkessë diskriminuese. Është e habitshme se si për njëtin AK dhe njëjti projekt i njëjti ekspert në lëndën 502/15 ka vlerësuar se AK në rast dyshimi mundet ta sqaroj me nenin 72, ndërsa në rastin konkret i jep drejtë AK-së. I propozojmë panelit të aprovohet ankesa dhe të përmirësohen kriteret sa i përket licencës me MMPH dhe të lejohet pjesëmarrja edhe pa licencë për menaxhimin e deponimeve dhe të lejohet marrëveshja me KMDK dhe përveç dudit doganorë të shtohet si dëshmi mundësia me faturë të blerjes apo kontratë blerjes.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së znj. Isufi deklaroj: Ne mbështesim mendimin e ekspertit shqyrtues. Çështja e licencës nuk është kriter diskriminues pasi çdo OE mundet të marr licencës nëse plotëson kriteret për marrjen e licencës. Arsyja pse nuk është cek në fillim është se nuk është cekur nga njësia kërkesës në fillim, mirëpo pas kërkesës për sqarim prej OE-ve në konsultim me njësinë e kërkesës na kanë konfirmuar se kjo është e domosdoshme. Sa i përket dëshmive për pronësinë e pajisjeve, kërkesa e AK-së ka qenë si gjithnjë nga AK që të dëshmohet me Dud doganor dhe vlen për gjithë OE-të njësoj.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sa i përket pretendimin ankimor lidhur me kriteret e dosjes së te tenderit dhe njoftimit për kontratë pika 7.1&7.2, nën pika 3, lidhur me kriterin “Licenca për menaxhimin e mbeturinave”. Paneli shqyrtues konstaton se nuk qëndron pretendimi ankimor i cekur si me lart përfaktin se kjo Licencë nuk favorizon apo diskriminon asnjë OE sepse e njëjtë licencë mundet të ketë çdo OE i cili aplikon dhe plotëson kriterin për marrjen e licencës, Po ashtu ky dokument sipas sqarimit të Autoriteti kontraktues është i nevojshëm duke u bazuar në atë se asnjë kompani e pa licencuar nuk mundet të nënshkruaj kontratë me deponim për menaxhimin e mbeturinave, që do të thotë se nuk mundet të dorëzoj mbeturinat e grumbulluar në qytet, pa marr parasysh sezonin e mirëmbajtjes, grumbullimi dhe dorëzimin e mbeturinave është veprim i përditshëm dhe të njëjtat duhet të dorëzohen në deponi.

Lidhur me pretendimin e ankuesit sa i përket kriterit të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë pika 9.1&9.2, nën pika 3, lidhur me kriterin “

3. OE – duhet te ofroj dëshmi qe posedon apo ka ne shfrytëzim pajisjet e përshkruara ne Aneksin 7 te dosjes se tenderit

3. Listën e pajisjeve me dëshmitë: DUD-at për ato automjete qe nuk kane librezë te qarkullimit, Librezat e qarkullimit. Nëse mjetet janë në shfrytëzim kontratat për shfrytëzimin e tyre

Paneli shqyrtues konstaton se kërkesa e cekur si me lart është keksë kufizuese e cila nuk u jep mundësi shumë ofertuesve te marrjen pjesë ne ketë aktivitet te prokurimit andaj AK-ja mund ta plotësoj/zgjeroj kërkesën e cekur si me lart duke iu ofruar mundësi sa me shumë pjesëmarrjeje operatorëve ekonomik te rijnë në këtë aktivitet te prokurimit, paneli shqyrtues konstaton kërkesa e vendosur tek pika 9.1&9.2, nën pika 3, lidhur me kriterin “

3. OE – duhet te ofroj dëshmi qe posedon apo ka ne shfrytëzim pajisjet e përshkruara ne

Aneksin 7 te dosjes se tenderit

3. Listën e pajisjeve me dëshmitë: DUD-at për ato automjete qe nuk kane librezë te qarkullimit, Librezat e qarkullimit. Nëse mjetet janë në shfrytëzim kontratat për shfrytëzimin e tyre, mund te zgjerohet ku do te ju epej mundësi ofertuesve qe përpos DUD-at, te kërkohet edhe dëshmi tjera si fatura të blerjes, kontrata të shitblerjes etj.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapositiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – “KK-Prishtinë ”,
- 1x1 OE- “El-Bau”shpk-Gjilan
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.